



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-14104
Kaçanik, 15.07.2026

PROCESVERBAL nga takimi publik i Kryetarit me qytetarë për gjashtë mujorin e parë për vitin 2026

Vendi: Salla e Kuvendit- Kaçanik
26.06.2026
Ora 14.00

Me qëllim të informimit dhe pjesëmarrjes së gjerë e aktive të qytetarëve, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi, ka mbajtur takimin e parë publik me qytetarë me temë: “Puna e Kryetarit – të arriturat dhe sfidat në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026”. Fillimisht, Kryetari përshëndeti qytetarët e përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, duke i falënderuar për pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar.

Në këtë takim, Kryetari prezantoi punët dhe aktivitetet komunale në secilin sektor gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Në sektorin e Shërbimeve Publike dhe Urbanizmit, ai theksoi se është arritur marrëveshja për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e ujit. Gjithashtu, janë duke u zhvilluar punimet për ndërtimin e rezervuarit të ujit në Dushkajë, funksionalizimin e disa burimeve të ujit, ndërtimin e kanalizimeve fekale dhe atmosferike, si dhe investime në hapësira publike përmes ndërtimit të parqeve, eliminimit të deponive ilegale dhe vendosjes së kamerave të sigurisë. Po ashtu, po vazhdojnë punimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përfshirë ndërtimin e rrugës përreth xhamisë dhe çarshisë së qytetit.

Në fushën e arsimit, Kryetari njoftoi se është siguruar transport falas për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, si dhe për nxënësit e shkollave fillore që përshkojnë mbi katër kilometra për të ndjekur mësimin dhe për grupet e marginalizuara. Ai përmendi gjithashtu rritjen e numrit të bursave, nënshkrimin e kontratës për digjitalizimin e shkollave, funksionalizimin e kamerave nëpër shkolla, si dhe zgjerimin e sistemit të kamerave në qytet.

Sa i përket administratës, u theksua se po vazhdon ofrimi i shërbimeve efikase dhe transparente për qytetarët. Në sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit janë vendosur kioskat në bulevard, është hartuar Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, ndërsa edhe këtë vit është mbështetur sektori i biznesit, ku janë përkrahur 17 biznese komunale.

Në sektorin e shëndetësisë janë zgjeruar shërbimet në QMF dhe AMF me zgjatjen e orarit të punës, si dhe janë funksionalizuar laboratorët në Doganaj dhe Kaçanik të Vjetër. Gjithashtu, janë rritur shërbimet specialistike me angazhimin e endokrinologut, gjinekologut, pulmologut, radiologut dhe internistit.

Kryetari theksoi se edhe në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë vazhduar aktivitete të shumta, janë mbështetur me subvencione organizata joqeveritare dhe klube sportive, si dhe janë ndërtuar terrene sportive. Po ashtu, ai rikujtoi se nga muaji janar ka filluar edhe mbështetja financiare për nënat lehona.

Të pranishmit në debat, qytetarë dhe administratorë të lagjeve e fshatrave, përgëzuan komunën për punët dhe arritjet e realizuara, ndërsa paraqitën edhe kërkesat dhe nevojat e lokaliteteve që përfaqësojnë.

Idriz Berisha- Janë 9 shtëpi pa kanalizim në hyrje të fshatit Llanishtë, ndërsa në disa vende ku është thënë se ka kamera për mos hedhje të mbeturinave ato nuk po shihen.

Kadri Dardhishta- Të vendosen kamera tek parku kah pjesa e Saniteksit si dhe një dukuri është dëmtimi i shenjave të vendosura. Poashtu duam të dimë nëse ka investime serioze në ish objektin e spitalit që ka qenë i destinuar për shërimin e pacientëve nga mushkëritë.

Ibrahim Dallosi- Ju përgëzojmë për punën e bërë, jemi të kënaqur me investimet e deritashme. Kërkojmë rregullimin e ndriçimit në Doganaj, të legalizohen rrugët që janë shtruar nga komuna si dhe të shënjëzohen pikat e rënies së dëshmorëve.

Ziber Luma- Rruga e Sharrit është e dëmtuar nga Sepetini deri në Glloboqicë, është bërë rrugë e pa kalueshme dhe e rrezikshme, ndërsa lokalet që veprojnë në fshatin Shtrazë janë në gjendje të vështirë shkak i rrugës. Poashtu kërkojmë staf më të madh të mjekëve në pikën mjekësorë në Glloboqicë si dhe të ketë kapacitete më të mëdha.

Azem Koraqi- Kanalizimi në Koraq ka mbetur keq, shkolla është duke u dëmtuar, të merren masa në sanimin e kësaj gjendje, poashtu kërkojmë ndërtimin e një përroske projekt i paraparë më herët por që nuk është ndërmarrë asgjë deri më tani.

Xhevdet Tifeku- Ndërtimi i disa rrugëve në këtë pjesë Tifek, Lamaj e Caka, si dhe të hapet rruga për të pllaka e dëshmorëve dhe martirëve.

Unik Shurdhani- nga Klubi Lepenci- a ka diçka konkrete për të stadiumi i qytetit?

Emrin Dema- Kërkojmë që për OJQ-të që mund të shkaktojnë dëme të ju ulen edhe subvencionet.

Kryetari i Komunës Sabedin Vishi duke u ndërlidhur me pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve tha se në kuadër të kontratës për ndërtimin e kanalizimeve do të zgjidhen edhe problemet e lartcekura, ndërsa për ndriçimin publik njoftoi se së shpejti pritet nënshkrimi i kontratës për mirëmbjtje të ndriçimit publik dhe të sanohen defektet nëpër terren .

Poashtu njoftoi se përmes kontratave për ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve lokale do të rregullohen rrugët, kurse për rrugën Gllloboqicë bëri të ditur se është nën kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës, kurse tek stadiumi parashihet ndërtimi i ulëseve si dhe rritje e subvencioneve për sport.

Takimi u përmbyll në ora 15:10 minuta.

Procesmbajtëse:

Fatlume Guri Selimi

